

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË FERIZAJ**, sipas gjyqtarit Dalip Bega ,me pjesëmarrjen e sek.juridike Fatmire Mani, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Isak Jashari nga Ferizaj, për shkak të kundërvajtjes nga neni 16.1.1 të Ligjit për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik, si dhe nenit 31,73 dhe 195 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më datën 24.06.2010 muar këtë:

### AKTVENDIM

I pandehuri Isak Aziz Jashari i lindur më 01.06.1950,me vendbanim në Ferizaj rr."H.Jashari"hy.1 nr.6.

### Ë shtë pë r g j e g j ë s

Sepse si zyrtar i lartë publik,benda afatit të lejuar ligjor gjegjesishtë deri më 31.03.2010 nuk e ka deklaruar pasurinë tek agjencia kundër kurropsionit në Prishtinë.

- me qka kryen kundërvajtje nga neni 16.1.1.të Ligjit për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik.
- andaj në bazë të dispozitave të theksuara ligjore,

### D E N O H E T

ME DENIM NË TË HOLLA në shumë prej 300.-€

Dënimin e shqiptuar në të holla ka për ta paguar në afatin prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi,në të kundërtën do ti zavendësohet në dënim burgu në kohëzgjatje prej 20 ditësh.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale të paguajnë shumën paushalle prej 5.- €, në të njëjtin afat sikurse edhe dënimin.

### A r s y e t i m

Agjencia kundër korrupsionit në Prishtinë,ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse nr.01/2317/10 të dt.08.06.2010 kundër të pandehurit , duke kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas dispozitave ligjore.

Gjyqtari filloj procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurin i cili në deklaratën e tij pranoi kundërvajtjen e cila i ngrkohet duke shtu se në muajin maj e ka dërgu formularin mbi prejardhjen e pasurisë tek agjencioni por të njëjtit nuk ia kanë pranuar,andaj nuk pati nevojë që të nxierren prova tjera.

Në bazë të kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse deklaratës së të pandehurit, si dhe shkresave tjera të lëndës, u konstatua se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet e kundërvajtjes nga dispozitat e shenuara më lartë andaj iu shqiptua një dënim i tillë në të holla me bindje se edhe me këtë lloj dënimi do të arrihet qëllimi i duhur ndëshkimor,që në të ardhmen mos të kryej kundërvajtje të tilla apo të ngjajshme.

Gjatë matjes së dënimit u morrën parasyshtë të gjitha rrethanat e parapara me nenin 7 të LK, në bazë të të cilave iu shqiptua dënimi i theksuar më lartë.

**KËSHILLA JURIDIKE:**Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë,në afatin prej 8 ditësh,nga dita e pranimit të këtij aktvendimi,nepërmes kësaj Gjykate, pa pagesë takse.

Vendosur në Gjykatën komunuale për kundërvajtje në Ferizaj.

Sek.juridike

Fatmire Mani-Haxhijaj

